



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
"HASAN PRISHTINA"
FAKULTETI I SHKENCAVE MATEMATIKE NATYRORE

Rr. Eqrem Çabej, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: +381-38-249-873 • E-mail: fshmn@uni-pr.edu • www.uni-pr.edu

FSHMN

Ref. nr. 1368

Prishtinë, Dt. 25.04.2024

RAPORT I VLERËSIMIT TË DORËSHKRIMIT TË PUNIMIT TE DIPLOMES
MASTER

FAKULTETI	FSHMN
Departamenti/ Programi	Biologjisë
Projektpropozimi	Niveli i stresit oksidativ te gruri i shkaktuar nga ndotja e tokës në zonën përreth shkrites së Ferronikelit në Drenas
Kandidati	Mimoza Sahiti
Mentori	Prof. Asoc. Dr. Bekim Gashi
Aprovimi i projekt propozimit në	Datë: 26.01.2023 dhe 28.03.2024
Këshillin e Fakultetit	Vendimi nr.: 377 dhe 1097

Vlerësimi i dorëshkrimit

Punimi i masterit i kandidatës **Mimoza Sahiti** është realizuar tërësisht sipas programit të aprovuar nga ana e Këshillit Shkencor-Mësimor të FSHMN-së, përmban 49 faqe dhe ka këtë përmbajtje: Abstrakti (në të dy gjuhët), Hyrje, Shqyrtimi i literaturës, Qëllimi i hulumtimit, Materiali dhe Metodat, Rezultatet, Diskutimi, Konkludimet, Rezyme-ja (në të dy gjuhët), Literatura. Punimi është i ilustruar me 3 tabela (në të cilat gjenden rezultatet) dhe 5 figura.

Në pjesën hyrëse kandidatja ofron të dhëna të rëndësishme për tokat bujqësore, efektet stresuese e metaleve të rënda në bimë dhe tolerancën e bimëve ndaj stresit të këtyre metaleve. Gjithashtu, në këtë pjesë ka paraqitur të dhëna edhe për gjininë dhe llojin në fjalë (*Triticum aestivum L.*) si dhe për ndikimin e antioksidantët enzimatikë dhe jo enzimatikë. Kjo pjesë është e strukturuar mjaft mirë dhe ka përmbajtje plotësisht në harmoni me temën e hulumtimit dhe rezultatet e pritura.

Qëllimi i studimit është i qartë dhe plotësisht i përmbushur me rezultatet e këtij hulumtimi. **Materiali dhe metodat**, janë përshkruar metodat standarde të cilat janë përdorur në këto hulumtime dhe metodat statistike për përpunimin statistikor të rezultateve të fituara që janë kryer me programin SPSS.

Rezultatet – janë paraqitur përmes tabelave dhe figurave.

Rezultatet e hulumtimit tregojnë se efekt stresues ka dheu në afërisë së shkrites, i cili ka

veprim inhibues që ndikon në efektin fotosintetik dhe shkakton stres oksidativ tek gruri.

Për çdo parametër të hulumtuar është bërë përpunimi statistikor i rezultateve, duke u llogaritur mesatarja aritmetike dhe diferenca ndërmjet trajtimeve me metalet e sipërpërmendura dhe gjithashtu janë nxjerr edhe dallimet sinjifikante për P 0.05.

Në kreun **Diskutimi**, kandidatja në mënyrë të detajuar i krahason rezultatet e fituara me rezultatet e autorëve, duke bërë interpretime dhe diskutime në saje të shfrytëzimit të literaturës bashkëkohore adekuate kryesisht të pas vitit 2002.

Në **Konkluzione dhe Rezyme**, në mënyrë koncize është dhënë përmbledhja dhe komentimi i rezultateve më të rëndësishme dhe signifikante.

Literatura përmban një numër të konsiderueshëm me referenca, shumica prej tyre publikime të 10 viteve të fundit, me ISSN dhe me Impakt faktor.


Konkluzionet dhe propozimi


Punimi i masterit i kandidatës Mimoza Sahiti, për nga forma dhe struktura u përgjigjet standardeve normale. Kandidatja në mënyrë të përpiktë dhe me pedanteri i ka realizuar qëllimet dhe detyrat e hulumtimit. Mënyra e realizimit të punës eksperimentale dhe interpretimit të rezultateve është në përputhje me kriteret shkencore. Komisioni pozitivisht i vlerëson rezultatet, ndërsa dorëshkrimin e punimit të masterit të vlefshëm dhe origjinal, që do të kontribuojë në të arriturat shkencore.


Duke u bazuar në të gjitha faktet e lartpërmendura, me kënaqësi i propozojmë Këshillit Shkencor-Mësimor të FSHMN-së, përkatësisht këshillit Mësimor të Departamentit të Biologjisë që të aprovoj vlerësimin pozitiv të dorëshkrimit dhe të lejoj mbrojtjen publike të punimit të masterit, me titull: **“Niveli i stresit oksidativ te gruri i shkaktuar nga ndotja e tokës në zonën përreth shkrites së Ferronikelit në Drenas”** titulli Anglisht: **“Level of oxidative stress in wheat due to soil contamination in the vicinity of the Ferronikel smelter in Drenas”**

Prishtinë, 22.04.2024

Komisioni:

1. 
Prof. dr. Elez Krasniqi – kryetar

2. 
Prof. asoc. dr. Bekim Gashi – anëtar

(mentor)
3. 
Prof. dr. Sali Aliu – anëtar